

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8317
E mërkurë, 10 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

ASK-ja: Më pak nxënës dhe studentë sesa një vit më parë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË DHE NDËRKOMBËTARËT KËRKOJNË FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5

OPINION

SINOERITETI PËRBALLË EGOCENTRICITETIT POLITIK F. 6

Shkruan:
Arben HOXHA



AKTUALE



KURTI VLERËSON MBËSHTETJEN E AUSTRISE NDAJ KOSOVËS F. 3

OSMANI NË CNN: PA INSTITUCIONE TË THEMELUARA SHPEJT, ËNDRRA E KOSOVËS PËR NATO-n DHE BE-NË MBETET LARG F. 3

EKONOMI



ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT E KOSOVËS DHE AJO E SUEDISË RIKONFIRMOJNË BASHKËPUNIMIN 15-VJEÇAR F. 8

SPORT



TETË VJET PA FADIL VOKRRIN, LEGJENDËN QË U BË IDENTITET I FUTBOLLIT TË KOSOVËS F. 11



Kryeministri në detyrë dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka paralajmëruar dialog me partitë politike, ndërsa

përfaqësuesit e PDK-së, të LDK-së dhe ambasada e Gjermanisë dhe ajo e Italisë kanë bërë thirrje për

bashkëpunim, stabilitet politik dhe krijim pa vonesa të institucioneve të reja të Kosovës



RAPORTI I DNV-së: ZGJEDHJE TË QETA, POR ME MË PAK ENTUZIAZËM PËR SHKAK TË 'LODHJES ZGJEDHORE' F. 5

PALATOVA: KOSOVA T'I PËRSHPEJTOJË REFORMAT DHE FUNKSIONALIZIMIN E INSTITUCIONEVE, 880 MILIONË EURO NË PRITJE F. 8



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mik: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHQIPTARËT PËR AMERIKËN: PROTESTAT NË SHQIPËRI NUK JANË KUNDËR INVESTIMEVE AMERIKANE, POR KËRKESË PËR TRANSPARENÇË

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Organizata Albanians for America (AFA) ka reaguar lidhur me protestat publike që po zhvillohen në Shqipëri për projektet e propozuara turistike dhe zhvillimore përgjatë bregdetit jugor, përfshirë debatet e fundit që lidhen me zonën e Zvërnecit. Në një deklaratë zyrtare, AFA thekson se shqetësimet e ngritura nga qytetarët shqiptarë nuk duhet të interpretohen si kundërshtim ndaj investimeve amerikane apo partneriteteve ndërkombëtare. "Shqiptarët prej kohësh e kanë mirëpritur angazhimin amerikan dhe vazhdojnë t'i konsiderojnë Shtetet e Bashkuara si një nga partnerët më të afërt dhe më të besueshëm të Shqipërisë", thuhet në deklaratë.

Organizata nënvizon se investimet e huaja të përgjegjshme mund të krijojnë vende pune, t'i zgjerojnë mundësitë ekonomike dhe të kontribuojnë në prosperitetin afatgjatë të vendit. Megjithatë, AFA vëren se zhvillimi i qëndrueshëm kërkon transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje kuptimplote të publikut në proceset vendimarrëse. Sipas organizatës, qytetarët kanë të drejtë legjitime të kërkojnë qartësi dhe informacion mbi projektet që mund të ndikojnë zonat e mbrojtura natyrore, komunitetet lokale, trashëgiminë kulturore dhe të ardhmen e vijës bregdetare shqiptare. Siç thuhet në njoftim, debati



aktual tejkalon një projekt të vetëm investimi dhe prek çështje themelore të qeverisjes demokratike. "Çështja me të cilën përballlet Shqipëria sot lidhet me mënyrën se si merren

vendimet me rëndësi kombëtare, si konsultohen komunitetet dhe si arrihet një ekuilibër ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe sundimit të ligjit," thekson

AFA. Organizata shprehet se demokracitë e forta ndërtohen kur institucionet dëgjojnë qytetarët, adresojnë shqetësimet publike në mënyrë të hapur dhe zhvillojnë iniciativa madhore përmes proceseve të qarta dhe të parashikueshme. Sipas saj, këto parime nuk përbëjnë pengesë për investimet, por janë bazë e rëndësishme për besimin afatgjatë të investitorëve dhe për rritjen e qëndrueshme ekonomike. AFA, gjithashtu, thekson se, ndërsa Shqipëria vazhdon rrugën drejt integritimit evropian, besimi i publikut mund të forcohet përmes vendimarrjes së hapur, qeverisjes së përgjegjshme dhe respektimit të pjesëmarrjes demokratike.

SHBA: BOSNJA S'MUND TA SHTYJË NDËRPRERJEN E VARËSISË NGA GAZI RUS

WASHINGTON, 9 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës thanë se do t'i monitorojnë me kujdes ata në Bosnje dhe Hercegovinë që "i japin përparësi përfitim politik në vend të sigurisë energjetike, të mbështetur në energjinë e besueshme amerikane dhe në ndërprerjen e varësisë nga gazi rus". Kështu u përgjigj Departamenti amerikan i Shtetit në pyetjen e Radios Evropa e Lirë lidhur me takimet e fundit të zyrtarëve të entitetit Republika Sërpska (RS) me përfaqësues të kompanisë energjetike ruse Gazprom, në një kohë kur Bashkimi Evropian po paralajmëron ndërprerjen graduale të importeve të gazit rus. "Duke pasur parasysh se BE-ja po e heq gradualisht gazin rus deri në vjeshtën e vitit 2027, Bosnja dhe Hercegovina nuk mund t'ia lejojë vetes vonesa", u tha në përgjigjen e DASH-it. Zyrtarët e Republikës Sërpska, mes tyre edhe përfaqësues të Qeverisë së entitetit dhe lideri i partisë në pushtet, Millorad

Dodik, gjatë ditëve të fundit kanë zhvilluar bisedime me drejtuesit e Gazpromit në Shën Petersburg. Vizita në Rusi vjen në një kohë kur autoritetet e RS-së vazhdojnë përgatitjet për ndërtimin e gazsjellësit të njohur si Ndërlidhja e Re Lindore, projekt që vlerësohet se kushton 500 milionë euro. Ky gazsjellës pritet ta lidhë këtë entitet me rrjetin në Serbi, përmes të cilit Bosnja dhe Hercegovina aktualisht furnizohet ekskluzivisht me gaz rus. Pas takimit në fund të majit, ministri i Energjetikës dhe Minierave të RS-së, Petar Gjokiq, konfirmoi se ky entitet i Bosnjës dhe Hercegovinës mbetet një partner i rëndësishëm i Gazprom-it në zhvillimin e infrastrukturës së gazit. Bosnja dhe Hercegovina aktualisht është plotësisht e varur nga gazi rus, me të cilin furnizohet përmes Serbisë nëpërmjet Rrjedhës Turke.



Autoritetet në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës planifikojnë ndërtimin e gazsjellësit të quajtur Ndërlidhja Jugore, përmes të cilit gazi do të vinte nga terminali i gazit të lëngshëm natyror (LNG) në ishullin Kërk në Kroaci. Në këtë projekt janë të përfshirë edhe investitorë amerikanë. Nga DASH-i theksuan se Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për partneritet

me Bosnjën dhe Hercegovinën, me qëllim diversifikimin e sektorit të saj energjetik. Gjithashtu, nga DASH-i theksuan se gazsjellësi Ndërlidhja Jugore ka qenë prioritet i Qeverisë amerikane gjatë tri administratave të fundit, dhe se ai do ta zgjerojë dhe diversifikojë sektorin energjetik të Bosnjës dhe Hercegovinës. "Duke i dhënë asaj kontroll më të madh mbi furnizimin me energji përmes

ofrimit të qasjes në gaz natyror dhe duke ulur varësinë nga një burim i vetëm, jo i besueshëm", thanë nga Departamenti amerikan i Shtetit. Siç u tha në përgjigje, eksporti i energjisë amerikane është shtylla qendrore e bashkëpunimit ekonomik të ShBA-së me partnerët evropianë. "ShBA-ja ka burime për të mbështetur përpjekjet evropiane për t'u shkëputur nga energjia ruse dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Kompanitë amerikane janë partnere të besueshme dhe janë të gatshme të ofrojnë mbështetje", thanë nga Departamenti amerikan i Shtetit në përgjigjen dërguar Radios Evropa e Lirë. Bosnja dhe Hercegovina konsumon çdo vit deri në 250 milionë metra kub gaz, i cili hyn në shtet fillimisht në Shepak në lindje, dhe përmes një traseje të ndërtuar gati 50 vjet më parë transportohet deri në Sarajevë, ku është numri më i madh i konsumatorëve, dhe më tej në Bosnjën qendrore.

"BISEDË SHUMË POZITIVE": ZELENSKY FLET ME TË DËRGUARIT E TRUMPIT, WITKOFFIT DHE KUSHNERIT



KIEV, 9 QERSHOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka njoftuar se zhvilloi një bisedë telefonike me Steve Witkoff dhe Jared Kushner, përfaqësues të presidentit të Shteteve të Bashkuara. "Sot, gjatë një ndalesë në Aeroportin e Kishinaiu-t, foli me të dërguarit e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Steve Witkoff dhe Jared Kushner. Një bisedë shumë pozitive", shtoi presidenti

ukrainas. "Jam mirënjohës për gatishmërinë e tyre për të punuar sa më aktivisht të jetë e mundur në javët e ardhshme për të rigjallëruar diplomacinë që synon t'i japë fund luftës së Rusisë kundër Ukrainës", theksoi ai. Zelensky shtoi se pjesa më e madhe e vëmendjes së botës është aktualisht e përqendruar në zhvillimet rreth Iranit, por theksoi se "qëllimi ynë i

përbashkët për paqen në Evropë mbetet në agjendë". Diskutuam perspektivat në kontekstin e Samitit të G7 dhe ngjarjeve të tjera në qershor. Përshkrova të dhënat që kemi në lidhje me atë që Moska synon. Jam mirënjohës për fjalët e respektit për ukrainasit dhe vlerësimin pozitiv të qëndrimeve të Ukrainës. Faleminderit, Amerikë! Faleminderit Moldavisë për mikpritjen", tha Zelensky.

Kurti vlerëson mbështetjen e Austrisë ndaj Kosovës

VJEN, 9 QERSHOR - Në kuadër të vizitës zyrtare në Vjenë, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, u prit në takim bilateral nga kancelari i Republikës Federale të Austrisë, Christian Stocker.

Kurti shprehu falënderime për mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë ndaj Kosovës që nga vitet '90, pastaj në shtetndërtim dhe në rrugën evropiane, po ashtu për kontributin në kuadër të KFOR-it.

Teksa vlerësoi mbështetjen e Austrisë ndaj Kosovës të shprehur në Komitetin e Ministrave, në Kishinau në maj të vitit 2026, kryeministri në detyrë Kurti theksoi se një nga

prioritetet më të larta të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbetet anëtarësimi në Këshillin e Evropës.

Ai nënvizoi rëndësinë e vazhdimin të mbështetjes nga Austria dhe rolin e saj në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Kryeministri në detyrë Kurti tha se mirëpret deklaratën e kancelarit Stocker në Tivat, se Bashkimi Evropian nuk është i plotë, i sigurt dhe i qëndrueshëm pa Ballkanin Perëndimor.

Pasi tha se Republika e Kosovës është e përcaktuar, e angazhuar dhe e përkushtuar në rrugën e saj të anëtarësimit,



kryeministri në detyrë Kurti foli për rëndësinë që BE-ja të përgjigjet me dhënien e statusit

të shtetit kandidat dhe hapjen e negociatave. Në takim u bisedua për

thelimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Austrisë, me theks të veçantë bashkëpunimin ekonomik e tregtar, investimet dhe rolin e rëndësishëm të mërgatës, energjinë dhe transformimin digjital. Ndërsa, u diskutua edhe për sigurinë, mbrojtjen dhe bashkëpunimin rajonal.

Kryeministri në detyrë Kurti uroi Austrinë për zgjedhjen anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2027-2028, ndërkaq pranoi urime për fitoren në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit.

OSMANI NË CNN: PA INSTITUCIONE TË THEMELUARA SHPEJT, ËNDRRA E KOSOVËS PËR NATO-n DHE BE-NË MBETET LARG

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Gazetarja e CNN International ka intervistuar ish-presidenten Vjosa Osmani ku ka theksuar se zgjedhjet e reja në Kosovë, si një nga vendet më të reja dhe më të varfra në Evropë, kanë dështuar të thyejnë muaj të tërë ngërç politik, duke rrezikuar ta fusin vendin më thellë në një krizë kushtetuese dhe ekonomike.

Në një intervistë direkte nga Prishtina për emisionin e CNN-it, Osmani paralajmëroi se ky bllokim institucional është shumë i pafat sepse ka dëmtuar interesat e Kosovës si brenda vendit për sa i përket ekonomisë, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Sipas saj, kriza filloi krejtësisht pa nevojë pikërisht në kohën kur po ndërtohej një momentum ndërkombëtar dhe po rritej mbështetja në botën perëndimore, veçanërisht me administratën e re të ShBA-së. Ajo theksoi se zëri i qytetarëve këtë herë është edhe më i qartë se ata duan kompromis midis forcave politike në mënyrë që institucionet të krijohen së bashku e jo vetëm nga një forcë politike.

Osmani shtoi se ndërsa vendet e



tjera në rajon mund të zgjedhin rrugën ku dikush kontrollon gjithçka, Kosova ka qenë gjithmonë model ku bashkimi dhe puna e përbashkët e forcave politike për interesat nacionale ka sjellë përfitime brenda dhe jashtë vendit.

Gazetarja e CNN-it solli në vëmendje sfidën e qeverisjes njëpartiake, duke specifikuar se

partia e kryeministrit Albin Kurti tani duhet të gjejë një partner koalicioni për ta formuar qeverinë e re dhe për të siguruar një shumicë prej dy të tretash për ta zgjedhur presidentin e ri.

E pyetur se çfarë kompromisesh janë realisht të mundshme për ta shmangur paralizën, Osmani theksoi se kompromisi duhet

arritur për tri institucionet: qeverinë e re, udhëheqjen e parlamentit dhe presidentin. "Kompromisi është vlera më e mirë që mund të kesh në politikë. Pra, të gjithë do të duhet të punojnë me njëri-tjetrin. Dhe ne jemi gati t'i japim vendit tonë pikërisht këtë", u shpreh ajo, duke saktësuar se është herët të thuhet se si do të

sillen partitë e tjera. "Jemi gati të ulemi dhe të bisedojmë me partitë politike, partitë e shumicës. Natyrisht, nuk duam të bisedojmë me partinë e vetme serbe që ka marrë pjesë në akte agresioni dhe shkelje të rendit kushtetues të Kosovës. Por çdo parti tjetër këtu, të gjithë rivalët e tjerë politikë janë të mirëpritur".

Më tutje, Osmani bëri thirrje për veprim urgjent, duke paralajmëruar afatet strikte ligjore dhe ripotencoi se para sfidave të sigurisë që shkaktohen nga Serbia dhe temave të integritimit euroatlantik, partitë shqiptare duhet të qëndrojnë të bashkuara. Ajo theksoi se është urgjente të gjendet një kompromis në interes të vendit duke i ditur afatet strikte ligjore, e me konkretisht afatin 60 ditore për zgjedhje të presidentit. Ajo përsëriti punën që kishte ndërmarrë Presidenca me shtetet anëtare të NATO-s dhe të BE-se, duke potencuar se muajt e krizave po krijojnë vonesa në rrugëtimin evropian dhe në anëtarësimin e nevojshëm në NATO, ndaj duhen institucione të shpejta për të vazhduar këto procese jetike për vendin.

Operacioni "White Star", arrestohen pesë persona

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Pesë persona janë arrestuar gjatë aksionit të zhvilluar në kuadër të hetimeve në rastin e njohur me emrin "White Star" të martën në disa lokacione.

Operacioni policor është realizuar nga Policia e Kosovës dhe ka përfshirë disa lokacione si në: Prishtinë, Pejë, Prizren, Viti dhe Drenas, nën monitorimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës, në bazë të urdhrin të lëshuar nga Gjykata Themelore.

Pesë personat janë ndaluar me vendim të prokurorit

special për 48 orë, nën dyshimin për përfshirje në veprat penale: pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar; blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve; si dhe pastrimi i parave.

Gjatë realizimit të urdhrin kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar prova relevante dhe pasuri të specifikuar duke përfshirë: 6 armë; 5 karikatorë; Lëndë narkotike e llojit kokainë 9.67 gramë; Fara mbjellëse të llojit marihuanë 35,18 gramë; 239 fishekë 239;

25 telefona 25; 7595 para të gatshme në euro; 10 automjete dhe 1 motoçikletë; 10 kompjuterë; 13 USB dhe 1 DVR; 16 ora dore etj.

Operacioni është mbështetur nga EUROPOL-i, autoritetet e Belgjikës, Francës dhe Holandës.

Pjesëtarë të këtyre institucioneve, së bashku me prokurorin e rastit kanë monitoruar operacionin policor nga vendi i ngjarjes. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës riafirmojnë angazhimin për luftimin e krimit të organizuar dhe



forcimin e sundimit të ligjit. Nëpërmjet bashkëpunimit institucional dhe veprimeve të koordinuara, do të vazhdojnë të ndërmarrin masa për

parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, duke siguruar llogaridhënie dhe respektim të procedurave ligjore.



PARTITË DHE NDËRKOMBËTARËT KËRKOJNË FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

Kryeministri në detyrë dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka paralajmëruar dialog me partitë politike, ndërsa përfaqësuesit e PDK-së, të LDK-së dhe ambasada e Gjermanisë dhe ajo e Italisë, kanë bërë thirrje për bashkëpunim, stabilitet politik dhe krijimin pa vonesa të institucioneve të reja të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Dy ditë pas zgjedhjeve të 7 qershorit, përfaqësuesit e partive politike kanë bërë thirrje që pas përfundimit të numërimit të votave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të mos humbet kohë në krijimin e institucioneve të reja.

Pas shpalljes së rezultateve, Kurti la të hapur mundësinë për dialog dhe bashkëpunim me partitë e tjera politike. "Në javët e ardhshme do të komunikojmë, do të takohemi dhe do të bashkëpunojmë me të gjitha subjektet politike", tha ai në një fjalim drejtuar mbështetësve të tij mbrëmjen e 7 qershorit. Nën kryetari i PDK-së, Shaqir Totaj, ka thënë se procesi zgjedhor i 7 qershorit tregoi edhe një herë maturinë e lartë demokratike të popullit tonë dhe aftësinë e institucioneve për të organizuar zgjedhje të lira, të qeta dhe sipas standardeve më të larta evropiane.

Ai i ka përgëzuar të gjithë aktorët që morën pjesë në këtë proces dhe i ka uruar fitoren LV-së, duke bërë thirrje për bashkëpunim, stabilitet dhe për një qeverisje

efikase. "Rezultatet preliminare flasin qartë, LV-ja ka dalë partia e parë dhe për këtë e përgëzojmë. Megjithatë qytetarët kanë dhënë mesazhin e tyre të prerë: Kosova ka nevojë për bashkëpunim, stabilitet dhe një qeverisje efikase. Asnjë parti nuk mund të ecë përpara e vetme; prandaj, është koha që t'i ulim tensionet elektorale dhe t'i lihet vendi dialogut të përgjegjshëm politik. Pres që të gjitha partitë, e posaçërisht VV të sillen konform këtij mesazhi të marrë nga qytetarët", ka shkruar Totaj në "Facebook".

Ai ka thënë se si subjekte politike e kanë detyrimin kushtetues dhe moral ndaj vendit që të shmangim çdo jostabilitet të ri të institucioneve. "Ftoj të gjithë liderët e partive parlamentare të angazhohen menjëherë për gjetjen e një konsensusi të gjerë për zgjedhjen e Presidentit të ri dhe formimin e shpejtë të një ekzekutivi stabil me mandat të plotë katërvjeçar. Kosova përballet me sfida të mëdha ekonomike dhe gjeopolitike që nuk presin. Interesi i shtetit dhe i qytetarëve tanë duhet të qëndrojë mbi çdo interes të ngushtë partiak", ka shkruar Totaj. Edhe ish-deputetja e Lidhjes

Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, e cila aktualisht është në mesin e më të votuarve në LDK në zgjedhjet e 7 qershorit, ka theksuar se mosdalja në votime e qytetarëve është mesazh për secilin politikan.

Bajrami në një postim në "Facebook" ka shkruar se rezultati i këtyre zgjedhjeve është thirrje për reflektim të thellë. "Qytetarët folën. Folën fort. Të zëshëm ishin edhe ata që nuk votuan fare! Faleminderit nga zemra të gjithë atyre që votuan LDK-në dhe na besuan. Faleminderit njerëzve tanë në struktura që punuan ditë e natë. Mosdalja në votime është po ashtu një mesazh i qartë për secilin prej nesh. E lexoj këtë rezultat si protestë qytetare! Abstenimi i tyre është thirrje për reflektim dhe llogaridhënie se pse erdhëm në situatën ku mbajmë zgjedhje për të shkuar përsëri në zgjedhje", ka thënë ajo.

Bajrami ka theksuar se pa asnjë dyshim, shumë qytetarë ndëshkuan partinë që kishte 51 për qind, e cila e keqpërdori, përbuzi dhe nuk e zbatoi vullnetin e popullit. "Njëkohësisht, edhe neve na thanë qartë se duhet më shumë punë, më shumë seriozitet dhe më shumë përkushtim që të na shohin si zgjidhje. Secili e ka kuptuar se tri palë zgjedhje u mbajtën jo për shkak të mospajtimeve: nëse duhet të prodhojmë apo të importojmë energji, jo sepse nuk u pajtuam për programe zhvillimore, por sepse tema qendrore u bë: kush ku do të ulet. Përfundimisht, është koha të mendojmë përtej

karrigeve. Dhe rezultati i këtyre zgjedhjeve është thirrje për reflektim sepse, nëse duam të jemi të sinqertë me veten, qartazi diku ia kemi huqur. Lidhja Demokratike e Kosovës është më shumë se një palë zgjedhje, më shumë se një rezultat dhe më shumë se një episod politik, andaj duhet reflektim i thellë për tu rikthyer më e fortë", ka thënë Bajrami.

Edhe vëmendja e partnerëve ndërkombëtarë u përqendrua te nevoja për formimin e shpejtë të institucioneve të reja.

Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë theksoi rëndësinë që Kosova të ketë institucione plotësisht të mandatuara dhe të qëndrueshme, "pa asnjë vonesë të mëtejshme". "Na duhet një partner i fortë me të cilin mund të punojmë. Progresi në rrugën drejt integritimit në BE varet nga të gjithë aktorët politikë që t'i lënë mënjanë dallimet e tyre dhe të punojnë së bashku në interesin më të mirë të vendit", thuhet në deklaratë.

Edhe Ambasada e Italisë në Prishtinë shfaq shpresën se negociatat paszgjedhore do të çojnë në formimin e shpejtë të institucioneve të reja, duke siguruar stabilitetin e nevojshëm për vazhdimin e reformave dhe adresimin e prioritetëve të qytetarëve. "Ne i inkurajojmë të gjithë udhëheqësit politikë që të angazhohen në dialog konstruktiv dhe të punojnë së bashku për të mirën e vendit dhe të ardhmen e tij", thuhet në deklaratën e Ambasadës italiane për Radion Evropa e Lirë.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, doli e para në zgjedhjet e 7 qershorit me 42.91 për qind të votave. Pas saj renditen Partia Demokratike e Kosovës me 21.08 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.60 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.17 për qind dhe Lista Serbe me 6.17 për qind.

Ndonëse votat me kusht dhe ato të diasporës nuk janë numëruar ende, rezultatet e deritanishme tregojnë disa ndryshime në pozicionim krahasuar me zgjedhjet e dhjetorit 2025.

KQZ-ja: Rezultatet përfundimtare më 26 qershor, certifikimi i tyre më 6 korrik

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) planifikon që rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të së dielës t'i shpallë më 26 qershor, ndërkaq certifikimin e tyre ta bëjë deri më 6 korrik.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për medie ka thënë se këto dy data janë vetëm planifikime nga ana e institucionit, pasi shpallja e rezultateve dhe certifikimi i tyre, ndër të tjera, varet edhe nga ankesat që mund të ushtrojnë palët për procesin. "Krejt kjo varet nga ecuria e aktiviteteve, dinamika e aktiviteteve që zhvillohen në këto qendra

RAPORTI I DnV-së: ZGJEDHJE TË QETA, POR ME MË PAK ENTUZIAZËM PËR SHKAK TË 'LODHJES ZGJEDHORE'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" (DnV) ka publikuar të martën Deklaratën Preliminare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026. DnV-ja ka vlerësuar se zgjedhjet e 7 qershorit u zhvilluan përgjithësisht në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të qeta. "Procesi zgjedhor u administrua në mënyrë profesionale dhe efikase, ndërsa votuesit patën mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë të lirë dhe të barabartë. Zgjedhjet u mbajtën në një kontekst të pazakontë politik dhe institucional, duke përbërë procesin e tretë zgjedhor në nivel vendi brenda një periudhe prej rreth gjashtëmbëdhjetë muajsh. Ky cikël i vazhdueshëm zgjedhor ishte pasojë e pamundësisë së akterëve politikë për të ndërtuar institucione stabile dhe për të siguruar konsensusin minimal të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit institucional. Në krahasim me proceset e fundit zgjedhore, fushata dhe Dita e Zgjedhjeve u karakterizuan nga një lodhje zgjedhore e manifestuar në riciklim të ofertave të kaluara politike dhe në ulje të motivimit qytetar për pjesëmarrje në zgjedhje", thuhet në këtë deklaratë.

Sipas DnV-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi shumicën e operacioneve zgjedhore në mënyrë profesionale dhe brenda afateve të parapara. "Ndryshe nga disa procese të mëhershme zgjedhore, puna e KQZ-së u karakterizua nga më pak përplasje politike dhe një proces vendimmarrës më funksional. Organizimi i votimit brenda dhe jashtë Kosovës, përgatitjet teknike për Ditën e Zgjedhjeve, si dhe komunikimi publik me votuesit, u realizuan përgjithësisht në mënyrë efektive. Megjithatë, në disa raste KQZ ndërmori veprime që tejkalonin bazën ligjore

ekzistuese, veçanërisht përmes disa dispozitave të miratuara në Rregulloren për Vëzhguesit e Zgjedhjeve dhe vendimit për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduar, i cili më pas u anulua nga PZAP", thuhet në deklaratë.

Sipas DnV-së, votimi jashtë Kosovës u zhvillua pa probleme serioze dhe pa debatet politike që kishin karakterizuar procese të mëhershme. "Interesimi i diasporës mbeti i lartë, me mbi 131 mijë votues të regjistruar dhe me pjesëmarrje mbi 82 % në votimin fizik në përfaqësitë diplomatike. Administrimi i këtij segmenti të procesit ishte përgjithësisht efektiv. Megjithatë, publikimi në rrjetet sociale i fotografive dhe videove që shfaqnin fletëvotime të plotësuar vazhdon të ngrejë shqetësime lidhur me fshehtësinë e votës dhe integritetin e votimit jashtë Kosovës", duke theksuar se fushata zgjedhore u zhvillua në një ambient konkurrues dhe përgjithësisht të qetë. "Subjektet politike patën mundësi të zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe të komunikojnë lirshëm me votuesit në të gjithë territorin e vendit. Diskursi politik ishte më i moderuar krahasuar me disa procese të mëhershme zgjedhore dhe nuk u shoqërua me incidente serioze. Megjithatë, barazia e garës mbeti një nga shqetësimet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Vendimet e Qeverisë në detyrë për ndarjen e pagesave të njëhershme financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe subvencionimin e linjave ajrore për mërgatën në prag të zgjedhjeve krijuan ndikim në ambientin zgjedhor dhe cenonin perceptimin e barazisë së garës ndërmjet konkurrentëve politikë", thuhet në deklaratën e DnV-së.

Sipas kësaj organizate, mediet luajtën rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve gjatë periudhës zgjedhore dhe ofruan hapësirë për prezantimin e qëndrimeve të subjekteve politike. "Megjithatë, raportimi dhe debatet publike shpesh u fokusuan më shumë në Potok, Zveçan, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot dhe Mitrovicë e Veriut. "Ndërkaq, pasdite aktivitetet do të fillojnë në Qendrat Komunale të 23 komunave të tjera", shtoi ai. Sipas zëdhënësit të KQZ-së, numërimi i votave të kandidatëve për deputetë pritet të përmbyllet brenda disa ditësh. Deri më tani numërimi i votave të rregullta është përmbyllur - pasi ai bëhet në klasa menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve - brenda disa orësh pas



dinamikat e garës dhe retorikën politike sesa në analizimin e programeve dhe politikave konkrete të propozuara nga garuesit. Njëkohësisht, fushata zgjedhore vazhdoi të zhvendoset në masë të konsiderueshme në hapësirën digjitale, ku rrjetet sociale shërbyen si një nga kanalet kryesore të komunikimit politik. Përdorimi intensiv i përmbajtjeve të sponsorizuara dhe materialeve video konfirmoi rëndësinë në rritje të platformave online në garën zgjedhore, por njëkohësisht evidentoi vazhdimin e sfidave që lidhen me dezinformimin dhe shpërndarjen e informacionit të paverifikuar. Oferta politike u fokusua kryesisht në çështje ekonomike dhe sociale, ndërsa debati publik shpesh dominohej nga mesazhe politike dhe slogane elektorale më shumë sesa nga diskutime të detajuara mbi politikën publike dhe realizueshmërinë e tyre. Fushata mbeti kryesisht e përqendruar rreth liderëve partiakë, ndërsa gratë vazhduan të jenë dukshëm më pak të përfaqësuara në debatet publike dhe hapësirën mediatike sesa në listat zgjedhore", ka vlerësuar DnV-ja, duke shtuar se dita e zgjedhjeve

u zhvillua në atmosferë të qetë dhe pa incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e procesit. "Hapja, votimi dhe mbyllja e vendvotimeve u administruan përgjithësisht në mënyrë të rregullt. Megjithatë, një nga problemet më të shprehura gjatë ditës mbeti vështirësia e votuesve për të gjetur vendvotimin e saktë, fenomen i evidentuar në një numër të konsiderueshëm vendvotimesh. Po ashtu, sfida vazhdon të mbetet qasja e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, si dhe rastet e fotografimit të fletëvotimeve dhe zbatimi jo gjithmonë i njëtrajtshëm i disa procedurave zgjedhore. Një zhvillim veçanërisht pozitiv i këtyre zgjedhjeve ishte rënia e ndjeshme e votimit me asistencë", thuhet në njoftim.

Të dhënat e DnV-së tregojnë se zbatimi më i rreptë i rregullave për këtë formë votimi ka ndikuar dukshëm në uljen e rasteve të evidentuara krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore, duke kontribuar në mbrojtjen e integritetit të votës. "Mekanizmat e drejtësisë zgjedhore funksionuan në mënyrë efektive gjatë tërë procesit. PZAP dhe

Gjykata Supreme trajtuan ankesat dhe kontestet zgjedhore në afatet e parapara ligjore dhe demonstuan nivel të lartë profesionalizmi dhe konsistence në vendimmarrje. Krahas tyre, Prokuroria dhe Policia e Kosovës luajtën rol aktiv në trajtimin e rasteve të dyshuara për shkelje të të drejtave zgjedhore dhe në ruajtjen e integritetit të procesit", është thënë në këtë deklaratë të DnV-së.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan në një ambient demokratik, konkurrues dhe të qetë.

"Administrimi i procesit zgjedhor ishte përgjithësisht profesional, ndërsa institucionet përgjegjëse arritën të menaxhojnë me sukses shumicën e sfidave organizative dhe procedurale. Megjithatë, përdorimi i masave me ndikim elektorale nga institucionet publike, vështirësitë e vazhdueshme në orientimin e votuesve, pengesat në qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe disa mangësi në zbatimin e procedurave zgjedhore mbeten çështje që kërkojnë adresim në proceset e ardhshme zgjedhore", ka vlerësuar DnV-ja.

[Qendrat komunale të Numërimit]. Gjithashtu, mes shpalljes së rezultateve përfundimtare dhe certifikimit ka një proces ankimor, i cili duhet të zhvillohet në institucione të ndryshme siç është PZAP-ja [Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtres] dhe Gjykata Supreme", ka thënë ai. Elezi ka njoftuar se, nga 38 komunat, numërimi i votave të kandidatëve për deputetë paraditen e së hënës ka nisur në 15 sosh: Leposaviq, Novobërdë, Obiliq, Shtime, Shtërpçë, Zubin

Potok, Zveçan, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot dhe Mitrovicë e Veriut. "Ndërkaq, pasdite aktivitetet do të fillojnë në Qendrat Komunale të 23 komunave të tjera", shtoi ai. Sipas zëdhënësit të KQZ-së, numërimi i votave të kandidatëve për deputetë pritet të përmbyllet brenda disa ditësh. Deri më tani numërimi i votave të rregullta është përmbyllur - pasi ai bëhet në klasa menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve - brenda disa orësh pas

përfundimit të votimit. Tani KQZ-ja bën verifikimin e votave për partitë, paralelisht me numrin e votave për kandidatët. Ndërkaq, pritet që të numërohen votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe të diasporës - ato nga përfaqësitë diplomatike dhe me postë. Sipas të dhënave të KQZ-së, për të votuar përmes postës ishin regjistruar 104 mijë e 480 votues, derisa në 30 përfaqësitë diplomatike të Kosovës kanë votuar 22 mijë e 414 nga 27 mijë e 724 shtetas të Kosovës që jetojnë

jashtë vendit. Por, derisa numri i atyre që votuan në përfaqësitë diplomatike dihet, për votuesit që zgjedhën ta dërgojnë votën me postë, zëdhënësi i KQZ-së tha se duhet të pritet verifikimi i zarfeve që kanë mbërritur në Kosovë nga jashtë. Sipas Elezit, ende nuk janë pranuar të gjitha paketat andaj edhe nuk kanë të dhëna përfundimtare për numrin e fletëvotimeve. Ai ka thënë se pas tërheqjes së fletëvotimeve nga votimi me postë, do të verifikohet nëse ato janë dërguar nga votuesit e regjistruar. "Para fillimit

të numërimit të fletëvotimeve nga këto lloje të votimit, KQZ-ja do ta bëjë skanimin e listave të votuesve të cilat janë përdorur në vendvotime. Ky skanim e ndihmon KQZ-në të verifikojë nëse ka ndonjë rast të votimit të dyfishtë".

Elezi ka bërë me dije se nga 52 vendvotime me kusht në 38 komuna të vendit, në përgjithësi janë evidentuar 8 751 të regjistruar, kurse në programin e votimit të personave me nevoja të veçanta të regjistruar kanë qenë 3 144 votues.

SINQERITETI PËRBALLË EGOCENTRICITETIT POLITIK



Shkruan: Arben HOXHA

Në fushatën zgjedhore që lamë pas, beteja e vërtetë politike nuk u zhvillua për programet politike dhe as rreth tyre. Beteja e vërtetë u zhvillua ndërmjet dy prirjeve karakterologjike të politikëbërjes: prirjes së egocentricitetit politik dhe prirjes së sinqeritetit politik. Të orientuara nga prirja e parë, partitë politike si VV-ja, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, në debatet dhe tubimet zgjedhore, interesin e partisë apo edhe të liderit të tyre përpiqeshin ta paraqisnin si të njëjtë me interesin e popullit dhe të shtetit. Edhe kur provat ishin të pakundërshtueshme dhe qartazi të verifikueshme, kritikantët e ndërsjella konsideroheshin si sulme armiqësore ndaj imazhit të idealizuar që ato kanë për veten dhe për liderët e tyre. Të orientuara nga prirja e egocentricitetit politik, ato përpiqeshin që çdo sukses shtetëror, para opinionit publik, ta paraqisnin si sukses ekskluziv personal të liderit partiak ose të partisë që ai përfaqëson. E udhëhequr nga prirja e sinqeritetit politik, si tipar karakterologjik i politikëbërjes, e cila bazohet në tërësinë e përkushtimit dhe në vënien e të gjithë qenies në shërbim të së vërtetës, të drejtës dhe lirisë, PSD-ja në këtë fushatë ishte antidoti i prirjes së egocentricitetit politik.

Rezultati zgjedhor prej 0,27% të votave për PSD-në nuk është tregues i humbjes së saj, por një tregues i dëmtimit të integritetit moral të elektoratit, i shkaktuar nga doktrina e egocentricitetit politik, e cila zbatimin e saj e ka gjetur në praktikën e politikëbërjes në Kosovë tash e më shumë se njëzet vjet. Egocentriciteti politik cak të veprimit të vet negativ ka divorcin e besimit nga shpresa e qytetarit për mundësinë e ndryshimit. Ernst Bloch, në veprën e tij "Principet e shpresës", thotë se shpresa është forca lëvizëse që e orienton njeriun drejt transformimit të botës, nga një stad më i ulët në një stad më të lartë zhvillimi. Ndërkaq, besimi është formësimi i kuptimit të mundësisë së transformimit të botës nëpër stadi të ndryshme. Egocentriciteti politik synon ndarjen e besimit nga shpresa, me qëllim që besimi pa shpresën të mbetet një dogmë për ushqimin e fanatizmit, ndërsa shpresa pa besimin të mbetet pa fuqinë e saj drejtuese. Efektet negative të kësaj ndarjeje, të shkaktuara nga egocentriciteti politik, në këto zgjedhje u manifestuan në dy forma: në njërin anë, përmes fanatizmit dogmatik partiak dhe, në anën tjetër, përmes refuzimit pasiv të qytetarëve për të marrë

pjesë në zgjedhje. Mospjesëmarrja e 63,4% të votuesve në zgjedhje është shprehje e heshtur e qëndrimit refuzues të qytetarëve ndaj zbatimit brutal, në kurriz të tyre, të prirjes së egocentricitetit politik. Shumësia e mundësive të zgjedhjes, që afirmon egocentricitetin politik në kontekstin e ndarjes së besimit nga shpresa, është në të vërtetë një bllokim i arsyes vlerësuese të qytetarëve për të zgjedhur. Shumësinë e mundësive egocentricitetit politik e shndërron në boshllëk mundësie. "Refuzimi pasiv" është shprehje e paqartësisë së vetëdijes të ndodhur përballë boshllëkut. Nën hegemoninë e pushtetit të egocentricitetit politik, edhe mundësia e vërtetë, e realizueshme në mënyrë të besueshme dhe kuptimplote, perceptohet si pamundësi. Rritja e egocentricitetit politik, si tipar karakterologjik i politikëbërjes në Kosovë, është tregues i rënies së sinqeritetit politik. Përfshirja në marrëdhënie me egocentricitetin politik është përfshirje në marrëdhënie varësie klienteliste. Sinqeriteti politik, jo si virtyt moral, por si parim i tërësishmërisë së veprimit të qenies, i vendos njerëzit në marrëdhënie me lirinë dhe

dinjtetin njerëzor. Refuzimi i PSD-së nga partitë politike dhe mediet televizive për të qenë pjesë e debateve zgjedhore ishte shprehje e frikës nga krahasimi i egocentricitetit politik me sinqeritetin politik; e frikës së egocentricitetit për t'u përballur me qëllimet e ulëta morale politike që mishëron brenda vetes. Sinqeriteti politik ishte pasqyra në të cilën egocentriciteti politik do ta shihte shëmtinë e vet. Mënyra më e sigurt për mbrojtjen e egocentricitetit politik nga vetja e vet, në pamundësi për ta thyer këtë pasqyrë, ishte përveçimi i saj ose heqja e saj nga hapësira e komunikimit publik. Më 22 mars 1998, mbi dy javë pas rënies së Jasharajve, në "zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale", populli i Kosovës mori pjesë në votime me mbi 95%. Në atë kohë, brenda radhëve të UÇK-së ishin përfshirë, ndoshta, jo më shumë se 0,2% e popullsisë. Po të mos ishte rezultati – LIRIA – i dalë nga flijimi i Jasharajve, lufta e UÇK-së dhe intervenimi i NATO-s, ne sot do të kishim një narrativë tjetër për Adem Jasharin. Pa rezultatin që e gëzojmë sot, Adem Jashari nuk do ta kishte epitetin "Legjendar". Nuk është larg mendsh se, në mungesë të këtij rezultati, Adem Jashari do ta pajisnim me ndonjë epitet

pezhorativ, që semantikisht do të shprehte "marrëzinë", pra një akt devijues dhe pengues në rrugën e çlirimit me mjete paqësore e demokratike. Flijimi i Jasharajve na ka dëshmuar se ligji i domosdoshmërisë së të vërtetës historike nuk mund të burgoset e as të tjetërsohet nga farsat e "proceseve demokratike" zgjedhore. Jasharajt dhe lufta e UÇK-së na kanë dëshmuar se jo frika që buron nga egocentriciteti politik, por guximi i sinqeritetit, i cili e vë në veprim tërë qenien në mbrojtje të së vërtetës, të drejtës dhe lirisë, është garantues i rezultatit të vërtetë dhe i qëndrueshmërisë së tij në raport me interesin publik dhe kombëtar. Formimi ose mosformimi i koalicioneve ndërmjet partive politike për konstituimin e institucioneve shtetërore (Kuvendit, Qeverisë dhe Presidencës), pas shpalljes së rezultateve zgjedhore, do të përcaktohet në varësi nga aftësia e prirjes së egocentricitetit politik për të zhdukur nga horizonti çdo mundësi të vendosjes së marrëdhënies së shëndosh ndërmjet besimit dhe shpresës brenda ndërgjegjes së shpirtit të popullit, si kusht themelor për rritjen e fuqisë së kontrollit politik dhe institucional.

Oficeri i FSK-së diplomon me sukses në ShBA

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, toger Arijanit Elshani, ka diplomuar me sukses të lartë në kursin e udhëheqjes për oficerët e Policisë Ushtarake (Military Police Basic Officer Leader Course), i cili është zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë vijimit të këtij programi profesional ushtarak, toger Elshani ka demonstruar nivel

të lartë të njohurive profesionale, aftësi udhëheqëse dhe përkushtim të vazhdueshëm në përmbushjen e detyrave dhe standardeve të kërkuara. Në shenjë vlerësimi për performancën e tij të shkëlqyer, ai është nderuar me çmimet prestigjioze "Honor Graduate" dhe "Iron Man", të cilat u ndahen oficerëve që dallohen për rezultate të larta

akademike, disiplinë, qëndrueshmëri fizike dhe përkushtim të jashtëzakonshëm gjatë shkollimit. Ky sukses përfaqëson një arritje të rëndësishme personale për toger Elshanin si dhe një dëshmi të profesionalizmit dhe përgatitjes së lartë të personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në institucionet më prestigjioze ushtarake ndërkombëtare.



Këshilli Shtetëror i Cilësisë shqyrtoi raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor, i ka shqyrtuar disa raporte të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe ka marrë vendime lidhur me to. Në këtë mbledhje, anëtarët e KShC-së kanë diskutuar për raportet e vlerësimit në kuadër të proceseve të akreditimit, duke shqyrtuar gjetjet, rekomandimet dhe vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë

për institucionet dhe programet përkatëse të arsimit të lartë. Po gjatë mbledhjes janë trajtuar kërkesa të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë, të cilat janë shqyrtuar në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullative të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Në kuadër të rendit të ditës, KShC ka diskutuar edhe çështje që lidhen me monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në proceset e mëhershme të akreditimit.

Këto mekanizma kanë për qëllim të sigurojnë se institucionet e arsimit të lartë i përmbushin standardet e cilësisë dhe vazhdojnë t'i përmirësojnë proceset akademike dhe institucionale. Gjithashtu, Këshilli ka shqyrtuar edhe çështje të ndërlidhura me ankesat si dhe është informuar për përgatitjet lidhur me Konferencën Vjetore të AKA-së 2026.

Agjencia e Kosovës për Akreditim mbetet e përkushtuar për zbatimin e



standardeve evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, duke garantuar procese

transparente, profesionale dhe të bazuara në vlerësime të pavarura ndërkombëtare.

ASK-ja: MË PAK NXËNËS DHE STUDENTË SESA NJË VIT MË PARË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka publikuar statistikën e arsimit për vitin shkollor 2025/2026. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2025/2026 ishte 62 085, prej tyre në sektorin publik ishin 56 892 ose 91,6 % dhe në sektorin privat ishin 5 193 ose 8,4 %. Ndërkaq, në vitin paraprak 2024/2025 ishte 63 551, prej tyre në sektorin publik ishin 58 337 ose 91,8 %, ndërsa në sektorin privat ishin 5 214 ose 8,2 %. Nga kjo mund të

shihet se ka rënie të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Kurse te sektori privat ka një rritje të lehtë të numrit të nxënësve. Ndërkaq numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin e lartë në vitin 2025/2026 ishte 64 671, prej tyre në universitetet publike ishin 34 208 studentë ose 52,9 %, ndërsa në kolegjet private ishte 30 463 studentë ose 47,1 %. Krahasuar me vitin paraprak 2024/2025, ka një rënie të lehtë të numrit të përgjithshëm të studentëve. Pra, në 2024/2025 ishin 64 817 studentë, prej tyre në universitetet publike 36 609 studentë ose 56,5 %, ndërsa në kolegjet private ishte 28 208 studentë ose 43,5 %.

Rritje e lehtë e numrit të fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor

Numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin shkollor 2025/2026 ishte 35 948, ku krahasuar me vitin paraprak (2024/2025), që ishte 34 038 fëmijë, kishte një rritje të lehtë të numrit prej 1 910 fëmijë më shumë. Në sektorin publik në vitin shkollor 2025/2026 ishin 24 422 fëmijë ose 67,9 %, ndërsa në sektorin privat ishin 11 526 fëmijë ose 32,1 %, ndërkaq me vitin paraprak (2024/2025) në sektorin publik ishin 23 349 fëmijë ose 68,6 %, ndërsa në

sektorin privat ishin 10 689 fëmijë ose 31,4 %.

Rënie e lehtë e numrit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët

Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2025/2026 ishte 198 639, prej tyre në sektorin publik ishin 194 314 ose 97,8 % dhe në sektorin privat 4 325 ose 2,2 %. Ndërkaq, në vitin shkollor 2024/2025 numri i nxënësve ishte 208 515, prej tyre në sektorin publik ishin 199 190 ose 95,5 % dhe në sektorin privat 9 325 ose 4,5 %. Nga kjo mund të



shihet se sektori publik ka një rritje të numrit të përgjithshëm, kurse sektori privat ka një rënie të lehtë të numrit të nxënësve krahasuar me vitin 2024/2025.

FSK-ja DHE GARDA KOMBËTARE E AJOVËS THELLOJNË BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Në vazhdim të bashkëpunimit, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jashari, ka pritur në takim zëvendësadjuantanin dhe udhëheqësin e Gardës Ajrore të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralbrigade Mark A. Muckey dhe stafin e tij. Fillimisht, gjeneral Jashari e falënderoi gjeneral Muckey për mbështetjen e vazhdueshme të Gardës Kombëtare të Ajovës në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke e cilësuar si 'storie suksesi' e partneritetit të këtij lloji. Gjithashtu, Jashari e



informoi për zhvillimet aktuale në FSK dhe për rolin e rëndësishëm në garantimin e

sigurisë në vend, duke theksuar kontributin e rëndësishëm të saj në ruajtjen e stabilitetit rajonal.

Në anën tjetër, Muckey e përgëzoi asharin për lidhshmërinë e tij dhe arritjet e deritanishme të FSK-së si dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjes së forcës Ajrore të GKA, në procesin e zhvillimit të mbrojtjes së hapësirës ajrore. Gjatë takimit të dy gjeneralët vlerësuan përparimin e konsiderueshëm të arritur nga FSK-ja në zhvillimin, modernizimin dhe avancimin e kapaciteteve të saj operacionale. Ata, gjithashtu, shprehën vlerësim të lartë për profesionalizmin, performancën dhe nivelin e lartë të ndërveprueshmërisë së

personelit në kuadër të aktiviteteve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Në përmbyllje të takimit, gjeneralët riafirmuan përkushtimin e tyre për avancimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, duke e cilësuar atë si një partneritet me rëndësi të veçantë strategjike. Në këtë kontekst, forcimi i kapaciteteve mbrojtëse të Republikës së Kosovës u vlerësua si një faktor kyç për garantimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes së qëndrueshme në rajon.

Agim Rexhepi dorëzon në AShAK Platformën Politike 100-vjeçare 2026-2126

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kryetari i Shoqatës "Miq të Amerikës", Agim Rexhepi, ka zhvilluar një takim me kryetaren e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK), akademiken Justina Shiroka-Pula, së cilës i ka dorëzuar zyrtarisht Platformën Politike 100-Vjeçare 2026-2126. Sipas

Rexhepit, platforma synon të nxisë debat dhe planifikim afatgjatë për të ardhmen e kombit shqiptar, duke u mbështetur në vlerat perëndimore, zhvillimin ekonomik, arsimin, diplomacinë dhe ruajtjen e identitetit kombëtar. Gjatë takimit ai paraqiti

projektin e tij edukativ i cili po zbatohet në shkolla të ndryshme të Kosovës përmes ligjëratave me nxënës dhe mësime të mësimdhënës. Projekti bazohet në Platformën Publike 100-vjeçare për orientimin prorepublican dhe miqësinë Kosovë - ShBA, me fokus edukimin e të rinjve mbi

demokracinë, qytetarinë aktive dhe partneritetet strategjike. "Në fund të takimit, pata kënaqësinë që znj. Justina Shiroka-Pula t'i dorëzoi një sasi të konsiderueshme materiale informative, përfshirë kartolina tematike, postera dhe libra, të cilat pasqyrojnë aktivitetin dhe misionin tonë në shërbim të



orientimit prorepublican, ruajtjes së miqësisë së përhershme Kosovë - ShBA dhe promovimit të vlerave demokratike", ka thënë Rexhepi.

RTK-ja pa paga të plota, sindikatat paralajmërojnë protesta nga e hëna nëse s'ka zgjidhje

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Sindikata e Pavarur e RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të RTK-së dhe Shoqata Sindikale e Radio Kosovës kanë protestuar të martën para objektit të RTK-së si reagim ndaj mosalokimit të plotë të pagave për punëtorët e RTK-së, raporton "Ekonomia Online".

Kërkesa kryesore e protestuesve ishte ekzekutimi i menjëhershëm i pjesës së mbetur të pagave dhe

respektimi i të drejtave themelore të të punësuarve.

Përfaqësuesi i sindikatave, Veton Rugova, tha se protesta është organizuar për mbrojtjen e dinjitetit të punëtorëve të RTK-së. "Sot tri sindikatat e RTK-së janë bashkë për të protestuar për mospagesën e plotë të pagës nga RTK-ja. Kjo nuk është çështje e një grupi. Kjo është çështje e çdo punëtori që me mund dhe përkushtim ka dhënë kontributin e tij për këtë institucion. Ne sot

jemi mbledhur këtu për të mbrojtur dinjitetin tonë si punëtorë. Për muaj e vite me radhë, punëtorët e RTK-së kanë qenë në krye të detyrës. Kemi raportuar në ditë të vështira. Kemi informuar opinionin në kohë krizash, zgjedhesh, fatkeqësish dhe ngjarsh të rëndësishme për vendin. Kemi mbajtur gjallë transmetuesin publik me profesionalizëm dhe përkushtim. Sot, pikërisht ata njerëz që kanë mbajtur RTK-në



në këmbë, po përballen me pasiguri për pagat e tyre. Kjo

është e padrejtë dhe e papranueshme", tha ai.

Ai paralajmëroi vazhdimin e protestave dhe veprimeve sindikale nëse deri të premtën nuk ka reagim konkret nga menaxhmenti dhe bordi i RTK-së. "Nëse deri të premtën nuk ka veprime konkrete nga menaxhmenti dhe Bordi i RTK-së, atëherë nga e hëna do të vazhdojmë me protesta dhe veprime të tjera sindikale", tha Rugova.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT E KOSOVËS DHE AJO E SUEDISË RIKONFIRMOJNË BASHKËPUNIMIN 15-VJEÇAR

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Auditorja e përgjithshme e Republikës së Kosovës, Vlora Spanca, zëvendësauditori i përgjithshëm Beza Halilaj, drejtoreja për Komunikim me Bashkëpunim Ndërkombëtar, Qendresa Mulaj dhe bashkëpunëtorët e tjerë priten në takim auditorin e përgjithshëm të Suedisë, Christina Gellerbrant Hagberg, drejtore të Bashkëpunim Ndërkombëtar, Eva Theisz si dhe këshilltarin e lartë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe menaxherin e projektit, Kameran Khudur.

Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale në fushën e auditimit publik, prioritetet strategjike të dy Institucioneve

Supreme të Auditimit si dhe mundësitë për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional. "Partneriteti afatgjatë me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë ka luajtur rol të rëndësishëm në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Falë këtij bashkëpunimi kemi forcuar funksionet tona të auditimit, kemi ngritur standardet e cilësisë dhe kemi konsoliduar praktika që sot janë pjesë përbërëse e punës sonë të përditshme, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies, transparencës dhe qeverisjes së mirë në Republikën e Kosovës", theksoi Auditorja e Përgjithshme, Vlora



Spanca. Auditorja e përgjithshme e Suedisë, Christina Gellerbrant Hagberg,

rikonfirmoi gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes profesionale në fusha me interes të përbashkët. "Jam e kënaqur

tekta shoh se investimi ynë i përbashkët në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës po jep rezultate konkrete në forcimin e kapaciteteve si në nivel individual ashtu edhe në nivel institucional, duke siguruar pajtueshmëri me parimet dhe standardet ndërkombëtare të auditimit", deklaroi ajo.

Delegacioni suedez u prit në takim të veçantë edhe nga ndihmësauditorët e përgjithshëm, drejtorët e Departamentit të Auditimit si dhe departamenteve profesionale mbështetëse.

Auditorja e përgjithshme e Suedisë me bashkëpunëtorë po qëndron për vizitë dyditore në Kosovë.

PALATOVA: KOSOVA T'I PËRSHPEJTOJË REFORMAT DHE FUNKSIONALIZIMIN E INSTITUCIONEVE, 880 MILIONË EURO NË PRITJE

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINT) ka lansuar Indeksën e Politikave për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM) 2026 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, ku është theksuar rëndësia e reformave ekonomike, mbështetjes për bizneset dhe përsheptimit të integritetit me standardet evropiane.

Eva Palatova, ushtruese e detyrës së shëfës së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, tha se 880 milionë euro janë në dispozicion për Kosovën në kuadër të Planit të Rritjes së



Bashkimit Evropian, por theksoi nevojën për përsheptim të

reformave dhe funksionalizim të institucioneve. "Të gjithë

pajtohem se zhvillimi i një sektori privat të fuqishëm në Ballkanin Perëndimor është thelbësor për zhvillimin socio-ekonomik dhe integrimin rajonal. Po ashtu, pajtohem se NVM-të dhe sipërmarrësit janë shtytës kyç të rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, krijimit të vendeve të punës, zhvillimit të aftësive dhe inovacionit. Kjo është arsyeja pse diskutimi i sotëm i nivelit të lartë mbi politikat që mund të forcojnë më tej konkurrueshmërinë dhe produktivitetin e NVM-ve dhe të krijojnë mjedise më miqësore për bizneset e vogla dhe të

mesme ka kaq shumë rëndësi", tha ajo, duke shtuar se në kuadër të Planit të Rritjes gjatë tre viteve janë të gatshme të investohen në Kosovë 880 milionë euro në këmbim të reformave. "Kosova ka paraqitur një agjendë ambicioze reformash në fushën e zhvillimit të sektorit privat dhe mjedisit biznesor. Kjo fushë e agjendës së reformave përfshin shtatë reforma kryesore dhe 26 hapa që synojnë promovimin e investimeve dhe eksporteve, një kornizë rregullative më të thjeshtuar dhe efektive dhe, në fund, nxitjen e inovacionit dhe rritjes së qëndrueshme gjithëpërfshirëse", tha ajo.

Rritet turizmi në Kosovë, mbi 67 mijë vizitorë qëndruan në hotele në prill

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelierisë për muajin prill 2026. Në prill 2026, numri i vizitorëve në hotele ishte 67 093, prej tyre vizitorë vendorë ishin 27 034 dhe vizitorë të jashtëm 40 060. Krahasuar me

muajin prill të vitit 2025 (sa ishin 54 812 vizitorë), pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 22,4 %.

Numri i net-qëndrimeve ishte 149 753, prej tyre 75 143 (50,1 %) nga vizitorët e jashtëm dhe 74 610 (ose 49,8 %) nga

vendorët. Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (prill 2025), pati rritje të vizitorëve për 23,5 %. Në total, 40 060 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.



TRUMP KA PARASHIKUAR 37 HERË DERI MË SOT MARRËVESHJE ME IRANIN...

Nga Aaron BLAKE, CNN

Kanë kaluar më shumë se dy muaj që kur Presidenti Donald Trump njoftoi një armëpushim me Iranin, duke thënë në atë kohë se të dyja palët ishin pranë një marrëveshjeje.

Trump tha në rrjetet sociale më 7 prill se ata kishin përparuar “shumë” në bisedime, por u duheshin dy javë që “Marrëveshja të përfundohej dhe të zyrtarizohej”. Ai e mbylli deklaratën duke thënë se “është një nder që ky problem afatgjatë po i afrohet zgjidhjes”.

Sigurisht, zgjidhje nuk pati. Por Trump, megjithatë, gjatë dy muajve që pasuan vazhdoi të sugjeronte se një marrëveshje ishte shumë afër. Madje shumë shpesh.

Duke përfshirë edhe periudhën para armëpushimit, ai e ka bërë këtë të paktën 37 herë. Ky është numri i rasteve kur ai ka thënë drejtpërdrejt — në postime në rrjetet sociale, dalje publike dhe telefonata me mediat — se një marrëveshje ishte pranë ose ka pretenduar se Irani ishte i dëshpëruar për ta arritur një të tillë.

Nuk ka asnjë tregues se kjo është më e vërtetë sot sesa ishte më 7 prill. Por Trump vazhdon ta thotë këtë, ose sepse është i shkëputur nga realiteti, ose sepse po përpriqet të qetësojë tregjet financiare, ose sepse mendon se mund ta bëjë marrëveshjen realitet vetëm duke e përsëritur.

Por është e qartë se ky nuk është më një pretendim që njerëzit duhet ta marrin seriozisht.

Gjithçka filloi më 23 mars, më pak se një muaj pas fillimit të luftës. Trump po u fliste gazetarëve jashtë avionit Air Force One për disa bisedime të supozuara paqeje dhe përmendi “pika kryesore pajtimi, do të thosha — pothuajse të gjitha pikat e



pajtimin”. Në fakt, Irani i mohoi negociatat.

Ditën tjetër, ai filloi të përsëriste atë që tashmë është kthyer në një refren të zakonshëm: se Irani ishte i dëshpëruar për të arritur një marrëveshje.

“Mendoj se do t’i japim fund,” shtoi Trump. “Nuk mund ta them me siguri.”

Më 25 mars, kjo u shndërrua në pretendimin se Irani donte “kaq shumë të bënte një marrëveshje”. Më 26 mars, në një mbledhje të kabinetit, Irani po “përgjerohej për të bërë një marrëveshje”.

Më 29 mars, gjatë një bisede me gazetarët në Air Force One, Trump u pyet nëse parashikonte arritjen e një marrëveshjeje javën e ardhshme, dhe ai u përgjigj: “Po, shoh një marrëveshje me Iranin, po.”

Presidenti Donald Trump u flet anëtarëve të medias në bordin e Air Force One, gjatë udhëtimit drejt Joint Base Andreës, Maryland, më 29 mars.

Parashikimet e Trumpit nisën të bëheshin më këmbëngulëse në

këtë pikë. Më 6 prill, ai tha se ata kishin qenë “shumë afër një marrëveshjeje” para një pengese.

Ditën tjetër, ai njoftoi armëpushimin, i cili fillimisht supozohej të zgjaste dy javë, ndërsa të dyja palët do të punonin për të finalizuar marrëveshjen.

Një javë më vonë, më 15 prill, ai i tha Fox Business: “Mendoj se është afër fundit, e shoh si shumë afër fundit.”

“Do të shohim çfarë do të ndodhë,” shtoi ai. “Mendoj se ata duan shumë të bëjnë një marrëveshje.”

Në ditët në vijim, Trump pothuajse dha garanci se gjithçka kishte marrë fund:

“Marrëveshja me Iranin duket shumë mirë dhe do të jetë një marrëveshje e mirë,” u tha ai gazetarëve më 16 prill.

Më 17 prill, ai pretendoi në tri dalje të ndryshme se Irani kishte “rënë dakord për gjithçka”, se “mendoj se do ta arrijmë marrëveshjen brenda një ose dy ditësh” dhe se “nuk mendoj se

ka shumë dallime të rëndësishme”.

Dhe më 20 prill, në një postim në Truth Social, ai parashikoi se “e gjitha do të ndodhë, relativisht shpejt!”

Pavarësisht se kjo nuk u realizua, Irani, sipas tij, ishte ende “duke vdekur për të bërë një marrëveshje” më 30 prill.

“Kur të përfundojë lufta, gjë që nuk duhet të zgjasë shumë...” u tha ai gazetarëve më 1 maj.

Trump i frenoi për pak kohë parashikimet e tij, përpara se të njoftonte më 18 maj se po shtynte sulmet ushtarake për “dy ose tri ditë” me kërkesë të vendeve të Lindjes së Mesme, “sepse ato mendojnë se janë shumë afër arritjes së një marrëveshjeje”.

Në këtë pikë, edhe vetë Trump dukej se e pranonte sa shpesh kishin dalë të gabuara parashikime të tilla.

“Kemi pasur periudha kur mendonim se ishim pak a shumë afër arritjes së një marrëveshjeje dhe nuk funksionoi,” tha Trump, përpara

se të shtonte: “Por kjo është pak ndryshe.”

Nuk ishte ndryshe. Por ai nuk u tërhoq.

“Do ta përfundojmë atë luftë shumë shpejt,” tha Trump më 19 maj në një piknik të Kongresit.

Më 23 maj, ai bëri përsëri deklaratën të ngjashme me ato të 17 prillit. Ai tha se administrata ishte “shumë më afër” një marrëveshjeje. Tha se marrëveshja ishte “në masë të madhe e negociuar, në pritje të finalizimit”. Dhe tha se marrëveshja do të shpallej “së shpejti” dhe se po diskutoheshin “aspektet përfundimtare”.

Më 28 maj, në një intervistë me nusen e djalit të tij, Lara Trump, gjërat ishin “afër një marrëveshjeje shumë të mirë”.

Dhe të dielën, ai siguroi se ata ishin “shumë afër arritjes së një marrëveshjeje”, por se Irani dhe Izraeli po e rrezikonin atë duke u përfshirë në një përplasje anësore.

“Jemi shumë afër një marrëveshjeje përfundimtare me Iranin,” i tha ai Axios. “Do të jetë një marrëveshje e mirë. Nuk dua që ajo të dështojë për shkak të asaj që po ndodh tani.”

Ishte të paktën hera e tretë që Trump i thoshte Axios se një marrëveshje ishte e afërt. Pastaj, të hënën, gjatë një tubimi telefonik për senatorin luftënxitës Lindsey Graham të Karolinës së Jugut, Trump parashikoi përsëri një “fitore totale” brenda dy javëve të ardhshme.

“Po negociojmë tani; ata duan të bëjnë një marrëveshje shumë të mirë,” tha Trump.

Pastaj shtoi: “Ata janë të gatshëm të na japin gjithçka.”

*<https://www.cnn.com/2026/06/09/politics/times-trump-iran-deal-close>

TEHERANI KONFIRMON NEGOCIATAT: PO PUNOHET PËR MEMORANDUM MIRËKUPTIMI, ARMËPUSHIMI ME SHBA-NË DO JETË GLOBAL

Përfaqësuesi i Iranit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Saeed Iravani, ka deklaruar se Irani dhe Shtetet e Bashkuara po shkëmbejnë propozime dhe pikëpamje në përpjekje për të arritur një marrëveshje përfundimtare përmes ndërmjetësimit të Pakistanit.

Sipas tij, të dy palët po punojnë për hartimin e një memorandum mirëkuptimi, megjithëse ende nuk është arritur

një tekst final.


“Ne po paraqesim dhe po shkëmbejmë pikëpamje dhe opinione për të arritur tekstin përfundimtar të një memorandum mirëkuptimi përmes Pakistanit. Ende nuk kemi arritur në tekstin përfundimtar, por po e ndjekim çështjen”, tha Iravani, sipas agjencisë shtetërore iraniane IRNA.

Ai shprehu gjithashtu optimizëm se procesi mund të përfundojë brenda këtij muaji.

Sipas tij, marrëveshja e mundshme do të shoqërohej me një armëpushim të gjerë rajonal. “Armëpushimi do të jetë global dhe do të mbulojë të gjithë rajonin, përfshirë Libanin”, deklaroi përfaqësuesi iranian.

Deklaratat vijnë në një moment tensionesh të larta në Lindjen e Mesme, ndërsa përpjekjet diplomatike po intensifikohen për të shmangur një përshkallëzim të mëtejshëm të konfliktit rajonal.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Venezia synon transferimin e Albion Rrahmanit

PRAGË, 9 QERSHOR - Skuadra e rikthyer në Serinë A, Venezia, po monitoron situatën e sulmuesit të Kombëtares së Kosovës, Albion Rrahmani, te Sparta e Pragës. "Sky Sport Italia" ka raportuar të martën se Venezia po e shih

Rrahmanin si përforsim për sezonin e ri në elitën e futbollit italian. Në fakt, mësohet se Venezia tashmë ka nisur kontaktet e para në lidhje me Rrahmanin, të cilin po e monitorojnë edhe disa skuadra të tjera të Evropës.

Mësohet se Sparta e Pragës është e gatshme ta shesë Rrahmanin për një tarifë prej tetë milionë eurosh dhe marrëveshja me Venezian mund të finalizohet brenda këtij muaji. 25-vjeçari në vitin 2024 iu bashkua Spartës së

Pragës dhe me ekipin nga Çekia ka kontratë afatgjatë, ndërsa karrierë ka bërë edhe në Rumani te Rapidi i Bukureshtit. Rrahmani ka realizuar 16 gola dhe ka bërë 4 asistime në 49 paraqitje në të gjitha garat për Spartën.



TETË VJET PA FADIL VOKRRIN, LEGJENDËN QË U BË IDENTITET I FUTBOLLIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Janë bërë tetë vjet që prej shkuarjes në amshim të legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Me këtë rast, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka thënë se emri i Fadil Vokrri është pjesë e identitetit të një kombi. "Ai ishte futbollisti më i madh që ka nxjerrë Kosova gjatë viteve të 80-ta dhe që gjatë karrierës së tij e barti me krenari fanellën me numrin 9. E pikërisht më 9 qershor 2018, ai u nda nga jeta, duke e lidhur përgjithmonë këtë numër me emrin dhe trashëgiminë e tij", ka shkruar Ademi në

"Facebook". Ademi ka thënë se edhe pas kaq vitesh prej ikjes së Vokrri, kujtimet për të mbesin po aq të forta. "Fadil Vokrri nuk ishte vetëm një golashënues i jashtëzakonshëm dhe një ikonë e futbollit. Ai besoi në ëndrrën e Kosovës kur ajo dukej e paarrtshme dhe punoi pa u ndalur për ta bërë realitet", ka shkruar ai.

Më tutje, presidenti i FFK-së ka numëruar edhe sukseset e 9-shes legjendare sa ishte në krye të udhëheqjes së futbollit të Kosovës. "Nga sukseset në fushën e blertë deri te

udhëheqja e futbollit të Kosovës drejt anëtarësimit në UEFA dhe FIFA, ai la gjurmë që nuk do të shlyhen kurrë. Numri 9 në fanellën e tij simbolizonte golat, suksesin dhe leadershipin. Data 9 qershor na kujton dhimbjen e humbjes së tij, por edhe përgjegjësinë për ta ruajtur dhe vazhduar rrugën që ai e ndërtoi. Fadil Vokrri mbetet më shumë se një emër në historinë e futbollit tonë. Ai është frymëzim, krenari dhe pjesë e përhershme e identitetit të futbollit të Kosovës. Përherë në kujtimet tona. Përherë legjendë", ka shkruar Ademi.



ADEMI UDHËTON DREJT MEKSIKËS DHE SHBA-SË PËR AKTIVITETET E FIFA-S NË KUADËR TË KUPËS SË BOTËS



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, është nisur drejt Mexico Cityt, qytetit ku dhjetë vjet më parë, në Kongresin e FIFA-s, Kosova ishte pranuar anëtare e barabartë e familjes botërore të futbollit.

Me ftesë të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, presidenti Ademi do të jetë në mesin e krerëve të të gjitha federatave anëtare të FIFA-s që do të marrin pjesë në ceremoninë dhe ndeshjen hapëse të Kupës së Botës 2026, ndërmjet Meksikës

dhe Afrikës së Jugut. Gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, presidenti Ademi do të marrë pjesë edhe në Samitin e FIFA-s i cili do të mbahet në Miami si dhe do të ndjekë nga afër disa ndeshje të fazës së grupeve të

Kampionatit Botëror. Më pas presidenti Ademi do të rikthehet në Kosovë, derisa me ftesë të presidentit Infantino, do të jetë i pranishëm edhe në ndeshjet gjysmëfinale dhe në finalen e madhe të Kupës së Botës 2026.

FIFA DO TA PAGUAJË NGA 4 MIJË EURO NË DITË ÇDO LOJTAR QË MERR PJESË NË BOTËRORIN 2026

ZURICH, 9 QERSHOR - FIFA ka vendosur t'i shpërblejë klubet që lejojnë futbollistët e tyre të marrin pjesë në Kupën e Botës 2026, duke vënë në dispozicion një fond rekord prej rreth 355 milionë dollarësh. Në kuadër të programit "FIFA Benefits", çdo klub do të përfitojë të paktën 5

mijë dollarë në ditë për secilin lojtar të grumbulluar nga kombëtarja e tij gjatë turneut. Përveç kësaj shume bazë, parashikohen edhe bonuse shtesë që do të llogariten në bazë të aktivizimeve në ndeshje dhe minutave të luajtura nga futbollistët. Sipas FIFA-s, shumata

përfundimtare që do të përfitojë secili klub do të përcaktohet vetëm pas përfundimit të kompeticionit, kur të jenë përlllogaritur të gjitha të dhënat e pjesëmarrjes së lojtarëve. Fondi i dedikuar për klubet është rritur ndjeshëm krahasuar me Kupa e Botës FIFA 2022 në Katar.

Rritja arrin në rreth 70 për qind, duke reflektuar angazhimin e FIFA-s për t'i kompensuar klubet që kontribuojnë me lojtarë në aktivitetet e kombëtareve. Pothuajse një e treta e fondit total është rezervuar për periudhën e ndeshjeve kualifikuese.



Atalanta insiston për Jasharin

MILAN, 9 QERSHOR - Atalanta është duke e sfiduar seriozisht skuadrën e Comos për shërbimet e mesfushorit Ardon Jashari i cili është pjesë e skuadrës së Milanit. Jashari mund të largohet nga Milani këtë verë pas largimit të

trajnerit Massimiliano Allegri dhe drejtorit sportiv Igli Tare. Tek Atalanta po e shohin Jasharin si përforsim i duhur për mesfushën dhe kanë bërë lëvizjet e para për t'i siguruar shërbimet e tij. Atalanta po pret përgjigjen e

Milanit, ekip që ende nuk ka vendosur nëse do ta shesë, huazojë apo do ta mbajë Jasharin duke pasur parasysh se mesfushori ka kontratë deri në vitin 2030. Jashari i është bashkuar Milanit verën e shkuar nga Brugge për 40

milionë euro, por lëndimi dhe problemet fizike nuk i kanë lejuar të ketë minuta të mjaftueshme në sezonin e tij të parë në Itali. Në total, Jashari ka regjistruar 17 paraqitje në të gjitha garat për Milanin, ndërsa ka bërë edhe një asistim.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “TechPro Services” SH.P.K. pronar Uran Ismaili, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812358126 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “TechPro Services” D.O.O. Uran Ismaili, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812358126 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “TechPro Services” L.L.C. Uran Ismaili, has come to the decision to quit its business: 812358126 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Prishtinë, 03.06.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 81050100 me adresë: Rr. „Adem Jashari“, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.05.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 0.57 MW ZK Prekallë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 0.57 MW ZK Prekallë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.6336-2/25 dt. 03.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 11-351-40062/145 dt. 21.11.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore Nr. 11-351-45958/158 dt. 30.12.2025 për “Instalimin e Sistemit Solar Fotovoltaik- me kapacitet 0.57 MW, ngastrata katastrale 00371-6, dhe 00371-7 ZK Prekallë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 5723 dt. 22.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shfytjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inzhineri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shfrytëzohet në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: elektrosystem16@gmail.com dhe LEGAL.LICENSING@ero-ks.org

Qasja në dasjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për atë që lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ismet Golaj B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 810241787 të lëshuar nga ARBK.

- Kadri Krasniqi nga Damjani kk Gjakovë shpall të pavlefshme certifikatën për bukëpjekës të lëshuar nga Q.A.P. në Prishtinë me nr. 1377/2018.

- “Flemingo Kosovo” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK “11 Marsi” Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl .VI - IX sh.f.m.u. “ Ibrahim Fehmiu” Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK “11 Marsi” Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

